

Data: 17.06.2026

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS - SHËRBIME**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Përditësim dhe përmirësim i platformës për operimin dhe administrimin në kohë reale të të gjithë moduleve të operimit të kaskadës, aktivizimi i licencave dhe mirëmbajta 4-vjeçare”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Shërbime të tjera – 98390000-3.

VLERA E FONDIT LIMIT: 250,000,000 (Dyqind e pesëdhjetë milionë) Lek pa TVSH ose 2,634,629 (Dy milionë e gjashtëqind e tridhjetë e katër mijë e gjashtëqind e njëzet e nëntë) Euro pa TVSH.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 17/06/2026 është 94.89 Lekë/Euro

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82, “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Nenit 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar. Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar citohet: “*Autoriteti Kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”, në Nenin 82, të LPP, i ndryshuar “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të*

vetdeklarimet, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Sa më sipër.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, i ndryshuar si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Duke marrë në konsideratë specifikën objekt prokurimi, kërkohet që Operatori Ekonomik ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me termat e referencës dhe specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë operatori ekonomik ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për tre vitet e fundit financiare të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e fondit limit.

Vlera e xhiros së përcaktuar dhe të kërkuar nga autoriteti kontraktor kërkohet për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike të operatorit ekonomik si dhe për të vendosur kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në dispozitat e legjislacionit :

Ligjin Nr. 29/2023 Për tatimin mbi të ardhurat (Ndryshuar me aktin normativ nr. 2, datë 7.6.2023; aktin normativ nr. 7, datë 14.12.2023; vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 52, datë 27.6.2024; aktin normativ nr. 4, datë 27.11.2024, ligjin nr. 9/2025, datë 30.1.2025; nr. 81/2025, datë 11.12.2025) (i përditësuar).

Vendim nr. 211, datë 9.4.2025 Për disa ndryshime në vendimin nr. 922, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave. “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”. Udhëzim nr. 24, datë 6.11.2025 për disa shtesa dhe një ndryshim në udhëzimin e përgjithshëm nr. 26, datë 8.9.2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 39 % e fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 3, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Kjo kërkesë ka si qëllim sigurimin e faktit që operatori ekonomik ka përvojë dhe aftësi të mjaftueshme për të realizuar kontrata të ngjashme me atë që po kërkohet. Në këtë mënyrë, AK synon të sigurojë se operatori ka kapacitetin për të përmbushur kërkesat dhe për të ofruar shërbime apo produkte që janë të ngjashme në natyrë dhe në vlerë me ato që janë të parashikuara në kontratë. Përvojat e mëparshme në kryerjen e shërbimeve të ngjashme janë një indikator i rëndësishëm i aftësisë së operatorëve për të menaxhuar projekte dhe për të përmbushur afatet dhe standardet e kërkuara. Nëse një operator ka një histori të suksesshme të realizimit të kontratave të ngjashme, kjo ul mundësinë e dështimit të kontratës së re, duke e bërë procesin më të sigurt dhe më të besueshëm për palën kontraktuese.

Operatorët ekonomikë që kanë përvojë të mëparshme në fushat e ngjashme janë më të besueshëm në ofrimin e produkteve dhe shërbimeve që kërkohen. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur bëhet fjalë për projekte që kërkojnë cilësi të lartë dhe përputhje me standardet. Përvoja e mëparshme tregon se operatori ka kapacitetin për të siguruar cilësinë dhe të përmbushë kërkesat kontraktuale.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikata ose ekuivalente të tyre, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- SSH ISO 9001: “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”.
- SSH ISO 27001: “Sistemi i menaxhimit të sigurisë informatike”.
- SSH ISO 20000-1: “Sistemi i menaxhimit të shërbimit”.
- SSH ISO 22301: “Sistemi i krijimit dhe mirëmbajtjes së vazhdueshme të sistemeve të menaxhimit”.

Argumentimi: *Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.*

-SSH ISO 9001: “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”

Argumentimi: *Me qëllim që gjatë zbatimit të këtij projekti të arrihet një sistem më i mirë menaxhimi, planifikim më i mirë i aktiviteteve, zgjidhje më e shpejtë e problemeve dhe rritje e produktivitetit, duhet që operatori ekonomik fitues të zbatojë standartin SSH ISO 9001: Ky standard bazohet në një numër parimesh të menaxhimit të cilësisë duke përfshirë një fokus të fortë të përfituesit të shërbimit, motivimin dhe implikimin e menaxhimit të lartë, qasjen e procesit dhe përmirësimin e vazhdueshëm. Përdorimi i këtij standardi ndihmon që përfituesi i projektit të marrë produkte dhe shërbime të qëndrueshme, të kualitetit të mirë, gjë që sjell përfitime të tij.*

-SSH ISO 27001: “Sistemi i menaxhimit të sigurisë informatike”.

Argumentimi: *Kërkesat e përcaktuara në këtë SSH ISO janë të domosdoshme për të garantuar sigurinë e procesit të përditësimit dhe konfigurimit të sistemit. Ky standard është i nevojshëm për përmirësimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e vazhdueshëm të një sistemi të menaxhimit të sigurisë së informacionit. Ky standard përfshinë kërkesat për vlerësimin dhe trajtimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit të përshtatura për nevojat e organizatës, me qëllim që informacioni të mbetet i sigurtë dhe të mos çënohet siguria e sistemeve të saj nga sulmet kibernetike. Operatori ekonomik fitues duhet të garantojë siguri gjatë procesit të punës, duke marrë masat e duhura të sigurisë së sistemit.*

-SSH ISO 20000-1: “Sistemi i Menaxhimit të shërbimit”.

Argumentimi: *Duke qenë së projekti përfshin ofrimin e një zgjidhjeje të gjithanshme dhe të shtrirë për mbledhjen e të dhënave e kombinuar me softuer të specializuar për parashikimin e flukseve hyrëse, parashikimin e konsumit të energjisë, planifikimin e prodhimit, tregtimin e energjisë dhe modelimin e tregut dhe duke marrë parasysh kompleksitetin e shërbimeve që do të implementohen, është kërkuar që operatori ekonomik*

të jetë i çertifikuar me SSH ISO 20000-1: i cili është një standard i sistemit të menaxhimit të shërbimit. Në këtë mënyrë operatori ekonomik fitues do të specifikojë kërkesat për ofruesin e shërbimit për të planifikuar, krijuar, zbatuar, operuar, monitoruar, rishikuar dhe mirëmbajtur sistemin. Kërkesat përfshijnë planifikimin, projektimin, tranzicionin, shpërndarjen dhe përmirësimin e shërbimeve të cilat përmbushin specifikimet teknike dhe japin vlerë për konsumatorët, përdoruesit dhe organizatën që ofron shërbime. Ky standard u jep kompanive mundësinë të demonstrojnë aftësitë profesionale të tyre në zbatimin e projekteve të teknologjisë së informacionit.

-SSH ISO 22301: "Sistemi i krijimit dhe mirëmbajtjes së vazhdueshme të sistemeve të menaxhimit".

Argumentimi: Duke qenë se kemi të bëjmë me përmirësimin e një platforme gjithëpërfshirëse e cila do të ndërveprojë përveç sistemeve të reja dhe me ato ekzistuese siç janë sistemi i parashikimit meteorologjik si dhe sistemi i shit-blerjes së energjisë, për institucionin është tepër e rëndësishme që ofruesi i shërbimit të jetë i çertifikuar për standardin SSH ISO 22301: i cili specifikon kërkesat për të planifikuar, krijuar, zbatuar, operuar, monitoruar, rishikuar, mirëmbajtur dhe përmirësuar vazhdimisht një sistem menaxhimi për të mbrojtur, zvogëluar gjasat e shfaqjes, përgatitur, përgjigjur dhe duke u rikuperuar nga incidentet kur ata lindin. Platforma në vetvete ka synim rritjen e performancës në menaxhimin e kaskadës për njësitë prodhuese, e cila duhet të ofrohet nga sisteme të cilat kanë vazhdueshmëri dhe të dhëna të sigurta të cilat përdorin gjithashtu të dhëna historike për të plotësuar databazën e optimizimit për pasojë lind nevoja e zbatimit të kërkesave sipas standarit të mësipërm.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga një prodhues ose një distributor i autorizuar nga prodhuesi për zgjidhjen software-ike për menaxhimin e kaskadës së lumit Drin planifikimin e prodhimit dhe modelimin e tregut.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga një prodhues ose një distributor i autorizuar nga prodhuesi për ndërveprimin e të dhënave me sistemin e parashikimit meteorologjik dhe platformën e menaxhimit të shitblerjes së energjisë.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit.

Argumentimi: Për sa i përket kritereve 2.3.3 dhe 2.3.4, kërkesat garantojnë Ak-në se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të shërbimeve të kërkuara në cilësinë dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike. Këto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesat për paraqitjen e Autorizimi nga Prodhuesi ose Distributor i Autorizuar për zgjidhjen software-ike për menaxhimin e kaskadës së lumit Drin planifikimin e prodhimit dhe modelimin e tregut

si dhe për ndërveprimin e të dhënave me sistemin e parashikimit meteorologjik dhe platformën e menaxhimit të shitblerjes së energjisë janë kërkesa që kanë si qëllim të sigurojnë se operatori ekonomik ka akses dhe mund të ofrojë produkte dhe shërbime të cilësisë së garantuar dhe të sigurta, si dhe të konfirmojë që ato janë në përputhje me standardet e prodhuesit ose distributorit të autorizuar.

Këto kritere kanë rëndësi të veçantë për të mbrojtur interesat e kontratës dhe sigurinë e sistemit, zgjidhjes softwer-ike si dhe të të dhënave të cilat janë thelbësore për mirëplanifikimin dhe tregtimin e energjisë elektrike. Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.




2.3.5 Ofertuesi duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 3(tre) punonjës, të diplomuar në një nga degët (Informatikë/Teknologji-Informacioni/Elektronike) si dhe të çertifikuar sipas kërkesave të mëposhtme:

- Minimalisht 1 (një) punonjës të çertifikuar për "ITIL Foundation - FONDACIONI ITIL" ose ekuivalente.

- Minimalisht 1 (një) punonjës të çertifikuar si administrator Database.

- Minimalisht 1 (një) punonjës të çertifikuar për "Software Business Analyst".

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklarimit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklarimit si:

-  Kontratë pune të vlefshme;
-  Çertifikata e mësipërme e vlefshme.
-  Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig për periudhën Mars 2026- Maj 2026.

Sqarim: Pranohen rastet kur një punonjës disponon më shumë se një çertifikatë, por në mënyrë të kombinuar stafi duhet të plotësojë minimumin e çertifikatave/dëshmimeve të kërkuar.

Argumentimi: Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. KESH sh.a, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

Në lidhje me diplomimin e punonjësve, argumentojmë se diplomimi në degët Informatike ose Teknologji-Informacioni ose Elektronike, është kërkuar në përputhje me objektin e prokurimit dhe termat e referencës pasi ky objekt prokurimi përfshinë ristrukturimin, optimizimin dhe avancimin e sistemeve ekzistuese të energjisë elektrike në KESH dhe instalimin e të gjitha informacioneve teknike të sistemit si dhe duhet të ofrojë trajnim për përdoruesit.

- Minimalisht 1 (një) punonjës të certifikuar për "ITIL Foundation- FONDACIONI ITIL" ose ekuivalente.

Argumentimi: Duke qenë se projekti konsiston në përshtatje të proceseve dhe shërbimeve aktuale sipas legjislacionit në fuqi, dhe shtimin proceseve dhe shërbimeve të reja, është e domosdoshme që operatori ekonomik fitues të ketë punonjës të certifikuar në menaxhimin e shërbimeve informatike. Punonjësi i certifikuar sipas standarteve ndërkombëtare do të ndihmojë gjatë fazës së realizimit të këtij projekti, duke përbushur nevojat e përfituesit përmes dizenjimit dhe implementimit të shërbimeve të reja dhe monitorimit e përmirësimit të shërbimeve ekzistuese.

- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si administrator Databaze.

Argumentimi: Të gjitha të dhënat e sistemit, përfshirë edhe ato të konfigurimit si dhe të përdoruesve të sistemit duhet të ruhen në një databazë e cila plotëson kërkesat në lidhje me integritetin e të dhënave dhe sigurinë. Për këtë arsye, nevojitet specialist i certifikuar për databaza, për një administrim sa më eficient dhe të sigurtë.

- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për "Software Business Analyst".

Argumentimi: Gjatë fazës së analizimit për ristrukturimin, optimizimin, përditësimin integrimin e projektit, operatori ekonomik fitues në bashkëpunim me përfituesit e shërbimit, duhet të kryejnë një analizë të hollësishme të bazës ligjore, proceseve dhe shërbimeve aktuale, mënyrës së punës dhe rrjedhës së saj. Gjithashtu, përveç ndërveprimeve aktuale dhe atyre të parashikuara në termat e referencës dhe specifikimet teknike, do të rishikohen edhe optimizime të tjera që mund të dalin si kërkesa të reja gjatë procesit. Për këtë arsye duhet të paktën një person i trajnuar dhe certifikuar për përmirësimin e proceseve dhe shërbimeve dhe optimizimet e mundshme në sistem, përmes analizës së të dhënave.

Shënim: Në plotësimin e "Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit", Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, në pikën B "Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate", OE ofertues duhet të shënojë në mënyrë të saktë, si prove paraprake: degën e studimeve të punonjësit, si dhe profilin përkatës të diplomës (nëse ka), si dhe emërtimet e certifikimeve përkatëse. Këto deklarime do të shqyrtohen kur OE ofertues do të paraqesë dokumentet origjinale ose kopje të noterizuara për punonjësit, pas shpalljes fitues së ofertës. Keqinformimi dhe deklarimi i rremë me qëllim kualifikimin e ofertës, në mënyrë të padrejtë, sanksionohet nga pika 1/a, të nenit 78 "Përfashtimi për një periudhë të caktuar nga Agjencia e Prokurimit Publik", të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik".

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, sipas parashikimeve të nenit 36 të Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Specifikimet teknike janë hartuar nga Grupi i punës (sipas procesverbalit pjesë integrale e kësaj procedure):

KESH sh.a. ka prokuruar dhe ka në zotërim infrastrukturën e një sistemi inteligjent për përpunimin e të dhënave hidrometeorologjike, analizimin e skenarëve të prodhimit dhe mbështetjen e vendimmarrjes për shitje/blerje të energjisë elektrike në raport me çmimet e tregut, ku motori kryesor i përpunimit të informacionit realizohet përmes platformës PLEXOS.

Ky sistem, për shkak të natyrës dinamike të të dhënave dhe ndryshimeve në tregjet e energjisë, kërkon në mënyrë periodike rinovimin e licencës, si dhe rishikimin teknik të komponentëve të tij, duke përfshirë:

- validimin e inputeve (të dhënave hyrëse),
- kalibrimin e modeleve dhe algoritmeve të përpunimit,
- si dhe verifikimin e saktësisë së outputeve (rezultateve të gjeneruara).

Aktualisht, sistemi përbëhet nga këto module kryesore:

- Moduli i parashikimit të prurjeve;
- Moduli i operimit;
- Moduli i tregimit;
- Motori i optimizimit PLEXOS.

Funksionaliteti i këtij sistemi konsiston në integrimin e të dhënave hyrëse (inputeve), përpunimin dhe analizimin e tyre përmes modeleve matematikore dhe algoritmeve të

optimizimit, si dhe gjenerimin e outputeve që shërbejnë për parashikim, planifikim dhe mbështetje të vendimmarrjes.

Në përfundim, bazuar në analizën e mësipërme dhe në nevojat e identifikuara, vlerësohet se përditësimi, mirëmbajtja dhe optimizimi i sistemit janë të domosdoshme për garantimin e funksionimit të qëndrueshëm dhe efikas të tij.

Njësia e Prokurimit